



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 594 / Prot

Tiranë, më 4 / 4 / 2017

Lënda: Mendim mbi projektvendimin "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore Arkiva Dixhitale e Arkivit Qëndror Teknik të Ndërtimit".

Drejtuar: Znj. Eglantina GJERMENI
MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN

Për Dijeni: Z.Gjergj THOMAI
DREJTOR I ARKIVIT QËNDROR TEKNIK TË NDËRTIMIT

Tiranë

E nderuar znj. Gjermeni,

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 1126/9 Prot, datë 29.03.2017, projektvendimi "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore arkiva dixhitale e arkivit qëndror teknik të ndërtimit" (ADAQTN), vlerësohet i hartuar konform kërkesave të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Kontrolluesi/Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit, në cilësinë e institucionit administrues të bazës së të dhënave, në raste të publikimit të tyre (të dhënave) duhet të konsultohet me kërkesat e nenit 7 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", për bërjen publike të informacionit pa kërkesë, të nenit 17 të po këtij ligji, ku përcaktohen kufizimet mbi bërjen publike të informacionit si dhe me kërkesat e Udhëzimit nr. 39, datë 05.08.2013 të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale në regjistrat publikë".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Beşnik DERVISHI

KOMISIONERI